



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 13.08.2026

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022 e plotësuar dhe ndryshuar me Rregulloren Nr. 002/2024, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës datës 07.08.2026, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Hamiti Group” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi dhe funksionalizimi i shtëpisë për mbrojtjen e fëmijëve”, Nr. i prokurimit- 632-26-5571-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-26-038-511, nxjerr:

V E N D I M

- 1. REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “Hamiti Group” SH.P.K., e dt.07.08.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi dhe funksionalizimi i shtëpisë për mbrojtjen e fëmijëve” Nr. i prokurimit- 632-26-5931-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-26-042-511, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të datës 10.07.2026, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. VËRTETOHET** dosja e tenderit dhe njoftimi për kontratë, e publikuar me datë: 10.07.2026;
- 3.** Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit, ashtu që Dosja e Tenderit mbetet në fuqi pa ndryshime.
- 4.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe i njëjti publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori ekonomik “Hamiti Group” SH.P.K., lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi dhe funksionalizimi i shtëpisë për mbrojtjen e fëmijëve”, Nr. i prokurimit- 632-26-5571-5-1-1, Nr. i brendshëm 632-26-038-511, .

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Gjakovës, më datë 13.08.2026, gjatë shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim, ka konstatuar se:

- **PRETENDIMI NR. 1** *lidhur me kërkesën për minimum 20 punëtorë*, është si i pabazuar.

Autoriteti Kontraktues vlerëson se kërkesa për disponueshmërinë e minimum 20 punëtorëve është përcaktuar duke marrë parasysh natyrën dhe kompleksitetin e kontratës, vëllimin e punëve që parashihet të realizohen, kohëzgjatjen e kontratës prej 36 muajsh, si dhe nevojën për realizimin e njëkohshëm të aktiviteteve dhe punëve të ndryshme ndërtimore dhe teknike.

Kërkesa për një numër të caktuar të fuqisë punëtore nuk nënkupton se Autoriteti Kontraktues kërkon që të gjithë punëtorët të jenë të angazhuar në mënyrë të pandërprerë gjatë gjithë periudhës së kontratës. Kjo kërkesë ka për qëllim të dëshmojë se Operatori Ekonomik disponon me kapacitetin e nevojshëm njerëzor për mobilizim dhe realizim të kontratës në përputhje me dinamikën dhe afatet e përcaktuara.

Fakti se Operatori Ekonomik mund të mobilizojë punëtorë pas nënshkrimit të kontratës nuk e bën kërkesën të paligjshme apo joproporcionale. Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të përcaktojë kërkesa për kapacitetin teknik dhe profesional të operatorëve ekonomikë, për atë sa ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe me nevojën për të siguruar realizimin e suksesshëm të saj.

Në rastin konkret, kërkesa është përcaktuar në funksion të sigurimit të kapacitetit të mjaftueshëm për realizimin e punëve, menaxhimin e proceseve të ndryshme të punës dhe respektimin e afateve kontraktuale.

Prandaj, vlerësohet se kërkesa për minimum 20 punëtorë është relevante, e arsyeshme dhe proporcionale me objektin dhe kompleksitetin e kontratës dhe nuk paraqet kufizim të pajustificuar të konkurrencës.

Për këto arsye, kërkesa juaj për largimin e këtij kriteri refuzohet.

- **PRETENDIMI NR. 2** *lidhur me numrin e profileve profesionale dhe kërkesën për së paku 5 vite përvojë*, është si i pabazuar.

Autoriteti Kontraktues vlerëson se kërkesa për personel profesional me profile të ndryshme është përcaktuar duke marrë parasysh natyrën multidisiplinare të punëve që janë objekt i kontratës.

Objekti i kontratës përfshin punë të fushave të ndryshme teknike dhe ndërtimore, të cilat kërkojnë mbikëqyrje dhe koordinim profesional në fusha si: ndërtimtaria, arkitektura, hidroteknika, elektroteknika, makineria, gjeodezia, siguria dhe shëndeti në punë, si dhe fusha të tjera relevante për realizimin e punimeve.

Kërkesa për përvojë profesionale prej së paku 5 viteve nuk është vendosur në mënyrë arbitrare, por synon të sigurojë që personat të cilët do të kenë përgjegjësi profesionale dhe teknike për realizimin e kontratës të posedojnë nivelin e nevojshëm të përvojës dhe kompetencës.

Veçanërisht, për një kontratë me kohëzgjatje prej 36 muajsh, me vlerë të konsiderueshme dhe me përfshirje të disa disiplinave teknike, Autoriteti Kontraktues ka vlerësuar se përvoja profesionale është element i rëndësishëm për menaxhimin, koordinimin dhe realizimin cilësor të punimeve.

Sa i përket pretendimit se kërkesa për inxhinier të mjedisit është e panevojshme, Autoriteti Kontraktues vlerëson se përfshirja e këtij profili profesional është e ndërlidhur me nevojën për respektimin e kërkesave dhe standardeve që lidhen me aspektet mjedisore gjatë realizimit të punimeve.

Gjithashtu, kërkesa për profile të ndryshme profesionale nuk nënkupton se të gjithë këta persona duhet të jenë të angazhuar në mënyrë të pandërprerë gjatë gjithë kohëzgjatjes së kontratës, por se Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë kapacitetin profesional të nevojshëm për realizimin e objektit të kontratës.

Autoriteti Kontraktues nuk ka përcaktuar kërkesa që lidhen me një operator ekonomik të caktuar apo me një markë, kompani apo person të caktuar, por ka përcaktuar kritere të përgjithshme dhe objektive të cilat mund të përmbushen nga të gjithë operatorët ekonomikë që posedojnë kapacitetet përkatëse.

Për rrjedhojë, vlerësohet se kërkesat për profilet profesionale dhe përvojën e tyre janë të lidhura drejtpërdrejt me objektin e kontratës, të arsyeshme dhe proporcionale, dhe nuk kanë për qëllim apo efekt eliminimin e konkurrencës.

Për këto arsye, pretendimi juaj refuzohet.

• **PRETENDIMI NR. 3** *lidhur me kërkesat për pajisjet dhe makineritë*, është si i pabazuar.

Autoriteti Kontraktues vlerëson se kërkesat e përcaktuara në Aneksin 7 për pajisjet dhe makineritë janë vendosur në bazë të nevojave reale teknike dhe operative për realizimin e punëve të parapara në kuadër të kontratës.

Përcaktimi i llojit, numrit dhe kapacitetit të pajisjeve është bërë duke marrë parasysh vëllimin e punëve, dinamikën e realizimit, nevojën për punë të njëkohshme në lokacione apo faza të ndryshme, si dhe kërkesën për përfundimin e punimeve brenda afateve kontraktuale.

Fakti që disa pajisje janë përcaktuar me kapacitete minimale ose maksimale nuk nënkupton se Autoriteti Kontraktues ka synuar favorizimin e një operatori të caktuar. Këto parametra janë përcaktuar për të siguruar që pajisjet të kenë kapacitetin dhe karakteristikat funksionale të nevojshme për realizimin e punimeve konkrete.

Në këtë drejtim, kërkesat për ekskavatorë, kamionë, valakë, auto-miksera, autopompa betoni, skela, dërrasa për kallëp dhe krana janë të ndërlidhura me nevojat operative të kontratës dhe me metodologjinë e paraparë të realizimit të punimeve.

Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të përcaktojë kërkesat teknike që i konsideron të nevojshme për sigurimin e cilësisë, sigurisë dhe realizimit në kohë të punimeve, përderisa këto kërkesa lidhen me objektin e kontratës.

Pretendimi se specifikimet e pajisjeve kufizojnë konkurrencën nuk është mbështetur me ndonjë dëshmi konkrete se kërkesat e përcaktuara janë të pamundura për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë ose se janë përcaktuar për të favorizuar një operator ekonomik të caktuar.

Për më tepër, qëllimi i kërkesave teknike nuk është kufizimi i tregut, por siguri i kapacitetit të mjaftueshëm teknik për realizimin e kontratës sipas standardeve dhe afateve të përcaktuara.

Prandaj, Autoriteti Kontraktues vlerëson se kërkesat e përcaktuara në Aneksin 7 janë të lidhura me objektin e kontratës, teknikisht të arsyeshme dhe proporcionale me nevojat e realizimit të saj.

Për këto arsye, pretendimi juaj refuzohet.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

Kopje:

Operatorit Ekonomik;

Zyrës së Kryetarit të Komunës;

Të gjitha palëve të interesuara;

EATON GUTAJ

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi